



## Udhëzues mbi projektin

**Lënda:     Projekt**

**Profesori: Prof.Dr. Ermir Rogova**

**Prishtine 2014**

## Qëllimi i projektit

Projekti ka për qëllim aftësimin e studentëve në disa aspekte.

- Puna grupore. Studentët pritet të zhvillojnë aktivitetin e tyre në grup duke zhvilluar kështu aftësitë e tyre interpersonale.
- Puna praktike. Studentët mund të zgjedhin që për projekt të realizojnë një aplikacion praktik. Duke bërë këtë, përveq se studentët zhvillojnë më tutje aftësitë e tyre programuese, ata edhe formojnë një pjesë të portfolios së tyre të punës.
- Aftësimi i studentëve për kërkim/hulumtim të materies, së bashku me zhvillimin e aftësive përmbledhësore (sumarizuese). Prej studentëve pritet që materialin e bollshëm që e gjejnë nga burimet e ndryshme, ta dijnë se si ta përmbledhin në një dokument i cili ka strukturë dhe rrjedhje.
- Referimi korrekt. Mos përdorimi i burimeve të informacionit në mënyrë të duhur për një ese, raport, projekt, punim, plan, analizë, artikull apo libër përbën plagjiaturë. Dhe plagjiatura është e dënueshme në të gjitha institucionet akademike, prandaj është shumë e rëndësishme afësimi në këtë drejtim. Nga studentët pritet që punimin e tyre ta referencojnë sipas rregullores për referenca (bashkangjitur).
- Prezantimi. Është një aftësi shumë e rëndësishme në kohën e sotme e cila përkthehet direkt në suksesin apo mos-suksesin e individit për të përquar informatën që i kërkohet, qoftë ajo prezantim për vetveten gjatë intervistës apo prezantimi i një pune të kryer para një komisioni. Prej studentëve pritet që në fund të semestrit ta prezantojnë punën e kryer nga secili prej tyre.
- Krijimi i raportit. Pëpilimi i raporteve është poashtu një aftësi e domosdoshme për studentët e nivelit master. Nga studentët pritet ta krijojnë një raport përfundimtar i cili përfshin të gjithë materialin e përmbledhur.

## Mënyra e notimit

Vlerësimi i punimit seminarik hulumtues përbëhet nga disa elemente. Secili student apo grup punues do të vlerësohet për punën e tyre.

Pjesë të vlerësimit do të jenë:

- Raportimet / prezentimet javore
- kualiteti i materialit të mbledhur apo i aplikacionit
- cilësia e raportit përfundimtar
- referimi i duhur
- prezantimi final

## Kërkesat

Prej studentëve kërkohet:

- Raportimet javore mbi punën e kryer
- Prezantimi përfundimtar grupor nga secili anëtar veq e veq për punën e kryer nga ata. Ose raportim individual në rastet e projekteve individuale. Ky prezantim duhet të jetë në PowerPoint dhe të zgjasë 15-20 min.
- Një kopje e raportit final në formë të shtypur dhe të lidhur, si dhe në formë elektronike (Word).

## Forma e raportit

Raporti pritet të ketë prej 20-30 faqe material ( pa përfshirë këtu ballinën, listen e përmbajtjes, citimet, etj.) dhe duhet të ketë formën sin ë vijim:

- Faqja e titullit/Ballina: (1 faqe)
  - Emri i Kolegjit
  - Emri i fakultetit/programit
  - Stema
  - Titulli i temës
  - Emri i mentorit dhe emrat e anëtarëve të grupit
  - Data e punimit
  
- Lista e përmbajtjes (1 faqe)
  
- Hyrja, (1 faqe)
  
- Shtjellimi i nëntemave për kapituj, (15-25 faqe)
  
- Konkluzionet/Përfundimet (1 faqe)
  
- Referencat (1-2 faqe)

**MOS HARRONI!** I gjithë materiali i mbledhur duhet të referohet. Këtu përfshihet teksti, figurat, tabelat, web faqet, etj.

## Referencat

Zakonisht faqja e referencave ka të bëjë me renditjen e të gjitha burimeve që keni përdorur në punim, sipas alfabetit në bazë të mbiemrit të autorit. Të gjitha burimet duhet të citohen në këtë pjesë.

- **Shtojcat dhe Figurat**
  - Kjo është pjesa ku kryesisht shënohen të dhënat, figurat, tabelat statistikore, kalkulimet etj. Secila shtojcë duhet të ketë titull.
- **Referencat në tekst**
  - Shënoni emrin e autorit dhe vitin p.sh: Adriani (1990) theksoi se....., apo një studim i fundit nga (Adriani, 1990) tregon se ...
  - Për më shumë autorë shëno të gjitha emrat e autorëve herën e parë si: Filani, Fisteku, Fisniku dhe Adami (1990), kurse herën e dytë: Filani et al. (1990), me pikë pas “al”.
  - Shëno numrin e faqes që i referoheni, pas vitit si p:sh (Lopez, 1993, f. 311),
  - Nëse keni më shumë se një autor, duhet të duket si: (Smith, Jones, et al., 1991) ose (Smith, Burke, et al., 1991).
- **Format e referimit:**
  - Nga autorë të panjohur (të marrë nga revistat):
    - Caffeine linked to mental illness. (1991, July 13). New York Times, pp. B13, B15.
- **Nga librat:**
  - Strunk, W., Jr., & White, E. B. (1979). The elements of style (3rd ed.). New York: Macmillan.
  - American Psychiatric Association. (1990). Diagnostic and statistical manual of mental disorders (3rd ed.). Washington, DC: Author.
  - Freud, S. (1961). The ego and the id. In J. Strachey (Ed. and Trans.), The standard edition of the complete psychological works of Sigmund Freud (Vol. 19, pp. 3-66). London: Hogarth Press. (Original work published 1923)
  - Referimi në tekst do të dukej si (Freud, 1923/1961).
- **Nga kapituj librash:**
  - Shapiro, K. L., & Raymond, J. E. (1994). Temporal allocation of visual attention: Inhibition or interference? In D. Dagenbach & T. H. Carr (Eds.), Inhibitory mechanisms in attention, memory, and language. New York: Academic Press.

- **Grup autorësh apo institucionesh:**
  - University of Pittsburgh. (1993) The title goes here. Journal of Something, 8, 5-9.
- **Nga artikujt shkencorë**
  - Spitch, M. L., Verzy, H. N., & Wilkie, D. M. (1993). Subjective shortening: A model of pigeons' memory for event duration. Journal of Experimental Psychology: Animal Behavior Processes, 9, 14-30.
- **Nga artikujt e revistave**
  - Gardner, H. (1991, December). Do babies sing a universal song? Psychology Today, pp. 70-76.
- **Mediet elektronike**
  - **FTP** : Bixley, T. S. (1995) Sentient microfilaments: A tempest in a tubule. [On-line]. Available:  
ftp://blahblah.princeton.edu/pub/harnad/psyc.95.3.26/consciousness/11/ bixley.
  - **Gopher**: Bixley, T. S. (1995) Sentient microfilaments: A tempest in a tubule. [On-line]. Available:  
gopher://somecomputer.princeton.edu/pub/harnad/psyc.95.3.26/consciousness/11/bixley.
  - **World Wide Web page** : Bixley, T. S. (1995) Sentient microfilaments Home Page. [On-line]. Available:  
http://www.microfilaments.com/consciousness/synchronicity/quantumtube.html.